

VENDIM
Nr. 5, datë 30.10.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Besnik Imeraj	kryesues
Gani Dizdari	anëtar
Ardian Dvorani	anëtar
Ardian Nuni	anëtar
Fatos Lulo	anëtar
Guxim Zenelaj	anëtar
Arjana Fullani	anëtare
Evelina Qirjako	anëtare
Majlinda Andrea	anëtare
Aleksandër Muskaj	anëtar
Mirela Fana	anëtare
Medi Bici	anëtar
Edmond Islamaj	anëtar
Shkëlzen Selimi	anëtar
Artan Zeneli	anëtar

në seancën gjyqësore të datës 30.10.2012 morën në shqyrtim çështjen civile nr. 3 akti, që u përket palëve:

PADITËS: Shoqëria “Dinamika” sh.p.k., përfaqësuar nga avokat Agron Lamaj

TË PADITUR: Hristo Çavo, përfaqësuar nga avokat Anastas Duro

Komuna Finiq, në mungesë

OBJEKTI I PADISË: Konstatim i pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes, datë 9.12.2003 dhe kontratës së shitjes nr. 512, datë 10.12.2003, lidhur midis palës së paditur komuna Finiq dhe Hristo Çavos.

BAZA LIGJORE: Nenet 153, 154 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 92/a/b i Kodit Civil.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 841, datë 6.10.2006, ka vendosur:

Pranimin e kërkesëpadisë së palës paditëse “Dinamika” sh.p.k.

Pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitjes në datën 9.10.2003 (9.12.2003) dhe kontratës së shitjes nr. 634/512, datë 10.12.2003, të lidhur midis palës së paditur Komuna Finiq dhe të paditurit Hristo Çavo.

Ligjërimin e masës së sigurimit të padisë.

Shpenzimet gjyqësore iu ngarkohen palëve të paditura.

Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr. 47, datë 20.2.2007, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit civil nr. 841, datë 6.10.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs i padituri Hristo Çavo, me të cilin kërkon ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, dhe rrëzimin e padisë, për këto shkaqe:

- Gjykata ka gabuar kur bën fjalë për heqjen e sheshit të ndërtimit të paditurit, për shkak të mospagimit të shumës në afat, pasi atij i është dhënë edhe leja e ndërtimit dhe për mospagim të shumës ligji nr. 7693, datë 6.4.1993 “Për urbanistikën”, parashikonte njoftimin për bërjen e pagesës, më pas vënien e gjobës dhe pastaj heqjen e sheshit të ndërtimit. I padituri nuk është njoftuar për bërjen e pagesës.

- Nga ana e komunës Finiq nuk ka asnjë akt për heqjen e sheshit të ndërtimit të paditurit.

- Në arkivin e komunës Finiq nuk gjendet asnjë akt për shitjen e bërë palës paditëse, prandaj

shitja e bërë të paditurit është e ligjshme.

- Gjykata nuk ka bërë një ekspertim për të arritur në përfundimin se kemi të bëjmë me të njëjtën sipërfaqe që pretendon pala paditëse, pasi në planvendosjen e palës paditëse, trualli ka kufizime të ndryshme nga ato të palës së paditur.

- Vendimet e të dyja gjykatave janë të cënueshme, pasi ato janë shprehur për pavlefshmërinë e veprimeve juridike pa u shprehur për rregullimin e pasojave.

- Në analizë të veprimeve administrative rezulton se vendimin e Këshillit të Rrethit Delvinë e ka anuluar këshilli i komunës Finiq, ç'ka do të thotë se nuk mundet që një organ administrativ të anulojë vendimet e një organi tjetër administrativ të të njëjtit nivel.

Pala paditëse, shoqëria "Dinamika" sh.p.k. ka ushtruar kundërrekurs, me të cilin kërkon mospranimin e rekursit, për këto shkaqe:

- Vendimet e gjykatave janë rrjedhojë e një gjykimi të drejtë dhe të bazuar në ligj.

- Me akte të ligjshme jemi bërë pronarë të një sipërfaqeje trualli prej 2250 m² (kontrata e datës 24.10.2002), ndodhur në zonën industriale Vrion të komunës Finiq, mbi të cilin do të ndërtohet nga ana jonë një objekt, sipas lejes së ndërtimit.

- Parcela, e cila na është dhënë ne për ndërtim, i është hequr me vendimin nr. 67, datë 21.11.2001 të komunës Finiq shtetasit Qani Xhuvani dhe jo të paditurit.

- Të paditurit i është hequr trualli për ndërtim në zbatim të ligjit për urbanistikën të vitit 1993.

- Aktet për kalimin e pronësisë së këtij trualli të paditurit janë bërë në një moment më të vonshëm (viti 2003), në kundërshtim me ligjin për urbanistikën dhe nenin 5 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve".

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 27.4.2011, duke marrë shkas nga çështja në shqyrtim dhe duke pasur parasysh se në praktikë kanë lindur keqkuptime të cilat kanë çuar në qëndrime të ndryshme për çështje të ngjashme, ka arritur në konkluzionin se është rasti të njësohet praktika gjyqësore lidhur me veprimin juridik absolutisht të pavlefshëm, mjetet e mbrojtjes juridike në rastet e kësaj pavlefshmërie, llojin dhe natyrën e padisë që mund të ngrihet bazuar në nenin 92 të Kodit Civil, si dhe zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, për efekt të njësimi të praktikës gjyqësore, para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka shtruar për diskutim këto çështje:

i) *Kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik duhet patjetër të bëhet gjatë gjykimit në themel të një çështjeje nga gjykata, i shoqëruar pra në çdo rast me një kërkim themeli, apo mund të paraqitet para gjykatës edhe si kërkim më vete?*

ii) *Në rastin e konstatimit nga gjykata të pavlefshmërisë së veprimit juridik, zgjidhja e pasojave të pavlefshmërisë sipas dispozitave të Kodit Civil bëhet kryesisht nga gjykata apo vetëm mbi kërkesën e palëve të veprimit juridik?*

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Ardian Nuni dhe Besnik Imeraj; përfaqësuesin e të paditurit Hristo Çavo, avokatin Anastas Duro, që kërkoi ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë; përfaqësuesin e palës paditëse, shoqërisë "Dinamika" sh.p.k., avokatin Agron Lamaj, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit; dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se me vendimin nr. 67, datë 21.11.2001 të këshillit të komunës Finiq shtetasit Qani Xhuvani i është hequr parcela nr. 23 prej 2250 m² dhe i është

dhënë për ndërtim shoqërisë “Dinamika” sh.p.k., duke u miratuar destinacioni i sheshit të ndërtimit dhe kondicionet urbane të tij.

1.1. Mbi bazën e këtyre akteve, midis seksionit të financës së komunës Finiq, me cilësinë e shitësit dhe shoqërisë “Dinamika” sh.p.k., me cilësinë e blerësit është lidhur kontrata e shitjes datë 24.10.2002, me anë të së cilës ka kaluar në pronësi të blerësit parcela nr. 23, me sipërfaqe 2250 m² e ndodhur në zonën industriale Vrion, me kufij: veriu-parcela 24, jugu-rrugë e parcela nr. 27, lindje - parcela nr. 24 dhe perëndimi - kolektor.

1.2. Në sipërfaqen e sipërcituar është bërë piketimi dhe pala paditëse ushtron aktivitetin e saj në funksion të shoqërisë, duke parkuar mjetet etj., deri në pritje të lejes së ndërtimit.

2. Nga ana tjetër, me vendimin nr. 201, datë 9.8.1995 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Rrethit Delvinë, të paditurit Hristo Çavo i është dhënë leja për shesh ndërtim, parcela nr. 23 me sipërfaqe 2250 m², ndodhur në komunën Finiq, me kufizimet përkatëse, si dhe leja e ndërtimit nr. 350, datë 18. 2.1996.

2.1. Me vendimin nr. 23, datë 10.6.1999 të këshillit të rrethit Delvinë, për shkak se nga personat ose investitorët nuk është bërë likuidimi i pagesës së trojeve, është vendosur heqja e disa shesheve ndërtimi, midis të cilëve dhe të paditurit. Ky vendim i është dërguar për ligjshmëri Prefektit të Qarkut Vlorë, por nga kjo prefekturë është kërkuar sqarim për arsyet e heqjes së shesheve të ndërtimit.

2.2. Me vendimin e datës 28.9.1999 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Rrethit Delvinë, midis të tjerëve, edhe të paditurit Hristo Çavo, i është anuluar leja e sheshit të ndërtimit në parcelën nr. 23 (nr. rendor 11).

2.3. Me vendimin e datës 28.9.2000 të këshillit të komunës Finiq është vendosur heqja e shesheve të ndërtimit për personat që nuk kanë paguar brenda 6 muajsh vlerën e truallit dhe është vendosur shitja e këtyre trojeve personave të tjerë.

2.4. Me vendimin nr. 57, datë 28.9.2001, këshilli i komunës Finiq u ka hequr trojet të gjithë personave që kishin marrë truall në zonën industriale Vrion, për shkak se kishte kaluar afati i pagesave dhe nuk kishin likuiduar detyrimet. Ky vendim është konsideruar i ligjshëm nga Prefektura e Qarkut Vlorë (shkresa nr. 1553/1, datë 10.10.2001)

2.5. Në vitin 2003 i padituri ka derdhur për llogari të komunës Finiq vlerën e truallit dhe, bazuar në vendimin e dhënies së sheshit të ndërtimit nr. 201, datë 9.8.1995 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Rrethit Delvinë, më datat 9.12.2003 dhe 10.12.2003 (nr. 634 rep., nr. 512 kol.) midis seksionit të financës së komunës Finiq, me cilësinë e shitësit dhe të paditurit Hristo Çavo, me cilësinë e blerësit, janë lidhur dy kontratat e shitjes së parcelës nr. 23 me sipërfaqe 2250 m², ndodhur në zonën industriale Vrion, kufizuar nga: veriu-parcela nr. 24, jugu - parcela nr. 22, lindja - parcela nr. 27 dhe perëndimi-gjelbërim.

2.6. Më datë 3.4.2006 i padituri Hristo Çavo i ka bërë kërkesë zyrës së urbanistikës të komunës Finiq për rifreskim të lejes së ndërtimit.

3. Pala paditëse, shoqëria “Dinamika” sh.p.k., me padinë e datës 5.5.2006, ka kërkuar “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes datë 9.12.2003 dhe nr. 634 rep., nr. 512 Kol., datë 10.12.2003, të lidhur midis palës së paditur komuna Finiq dhe Hristo Çavo”, duke pretenduar se ato janë lidhur në kundërshtim me ligjin, pasi komuna Finiq nuk mund të shiste një pronë që nuk ishte e saj.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 841, datë 6.10.2006, ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë së palës paditëse “Dinamika” sh.p.k. Pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitjes më datë 9.10.2003 (9.12.2003), dhe kontratës së shitjes nr. 634/512, datë 10.12.2003 të lidhur midis palës së paditur komuna Finiq dhe të paditurit Hristo Çavo”.

4.1. Në pranimin e padisë gjykata arsyeton se Këshilli i Rrethit Delvinë “..., me vendimin nr. 23, datë 10.6.1999, u ka hequr sheshet e ndërtimit disa personave dhe ndërmjet tyre është dhe shtetasi i paditur Hristo Çavo, pra që nga ky moment i padituri Hristo Çavo është zhveshur nga pronësia, dhe me parcelat që u janë hequr këtyre shtetasve janë pajisur shtetas të tjerë...” dhe “...çdo veprim që është bërë nga komuna Finiq është absolutisht i pavlefshëm, në bazë të nenit 92/a/b të K.Civil dhe si

rrjedhojë të dyja kontratat e sipërcituara duhen të konstatohen absolutisht të pavlefshme, pasi janë lidhur në kundërshtim me ligjin”.

5. Me të njëjtin arsyetim, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 47, datë 20.2.2007, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

6. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs i padituri Hristo Çavo, me të cilin kërkon ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë, për shkaqet e pasqyruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

7. Pala paditëse, shoqëria “Dinamika” sh.p.k. ka ushtruar kundërrekurs me të cilin kërkon mospranimin e rekursit, për shkaqet e pasqyruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

LIGJI I ZBATUESHËM

8. Dispozitat e Kodit Civil dhe ato të Kodit të Procedurës Civile, në të cilat është parashikuar:

8.1. Neni 79§1 i K.Civil: “Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”.

8.2. Neni 92 i K.Civil: “Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që:

a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit;

b) kryhen për të mashtruar ligjin;

c) kryhen nga të mitur nën moshën katërmëdhjetë vjeç;

ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasojë juridike (fiktive ose të simuluar)”.

8.3. Neni 31 i K.Pr.Civile: “Padia është e drejta e personit që bën pretendimin për t’u dëgjuar mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo.

Padia i jep të drejtën palës tjetër kundërshtare, për të diskutuar mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të këtij pretendimi”.

8.4. Neni 32 i K.Pr.Civile: “Padia mund të ngrihet:

a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur;

b) për vërtetimin e qenies ose mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte;

c) për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasojë juridike për paditësin”.

8.5. Neni 468 i K.Pr.Civile: “Gjykata e apelit, kur konstaton se çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si edhe kur padia nuk mund të ngrihet ose gjykimi nuk mund të vazhonte, prish vendimin dhe vendos vetë pushimin e gjykimit të çështjes”.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË VLERËSOJNË:

9. Se në lidhje me çështjet e shtruar për njësim të praktikës gjyqësore, konstatohet ekzistenca e praktikave “të ndryshme e të mëparshme” të kolegjeve të Gjykatës së Lartë. Pra, ndodhemi përpara rasteve të parashikuara në nenin 141/2 të Kushtetutës dhe në nenin 481§1 të Kodit të Procedurës Civile.

10. Për zgjidhjen e problemeve për të cilat çështja ka kaluar për njësim të praktikës gjyqësore, referuar dispozitave të Kodit Civil dhe atyre të Kodit të Procedurës Civile, Kolegjet e Bashkuara marrin në konsideratë:

i) Karakteristikat, kuptimin dhe natyrën e veprimeve juridike;

ii) kuptimin, elementet dhe karakteristikat thelbësore të pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik;

iii) kuptimin dhe veçoritë e padisë si mjeti kryesor për mbrojtjen dhe rivendosjen gjyqësisht të së drejtave civile të shkelura;

iv) traditën juridike shqiptare në lidhje me këto institute.

11. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë veçojnë nga ky trajtim aktet administrative të nxjerra nga organet e administratës shtetërore dhe pushteti lokal, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, nga veprimet juridike. Ky dallim bëhet për shkak se aktet administrative janë shprehje e vullnetit të organeve të sipërpërmendura në funksion të ushtrimit të kompetencave të tyre në bazë të ligjit dhe sjellin pasojë juridike si akte të organeve të pushtetit, pra i përkasin fushës së të

drejtës publike.

11.1. Gjithashtu, nuk janë objekt trajtimi disa veprime juridike që i përkasin fushës së të drejtës familjare, për rastet e pavlefshmërisë së martesës. ^[1]

12. Përkufizimi i veprimit juridik jepet në nenin 79 të Kodit Civil, sipas të cilit “*Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile*”.

12.1. Në thelb, veprimi juridik është një nënkategori e veprimeve të ligjshme të njerëzve.

13. Në vështrim të tërësisë së dispozitave që rregullojnë institutin e pavlefshmërisë së veprimeve juridike, veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm mund të përcaktohet si veprim juridik, i cili, për shkak të shkeljes së ligjit ose për shkak tjetër të parashikuar në ligj, nuk ka fuqi juridike ose është i paaftë të sjellë pasojat juridike të synuara nga palët.

14. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim:

i) veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët;

ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm;

iii) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (*quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest*);

iv) këto dy karakteristika, rrjedhojë dhe në paparashkrueshmërinë e së drejtës për goditjen e një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm.

15. Në kushtet e mësipërme, kur veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm nuk prodhon pasoja juridike dhe nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim a disponim të mëpasëm, kur nuk ka situatë konkrete cenimi apo shkelje të ndonjë të drejte subjektive materiale, për atë veprim juridik nuk mund të kërkohet në gjykatë, si kërkim i mëvetësuar, pavlefshmëria absolute.

15.1. Në të kundërt, kur ekziston një situatë konkrete cenimi, paditësi mund të ngrejë padinë e themelit në mbrojtje të së drejtës subjektive të cenuar dhe pavlefshmëria absolute e veprimit juridik mund të vihet në diskutim gjatë gjyqimit, qoftë edhe në mënyrë incidentale.

16. Kolegjet e Bashkuara e gjejnë me vend të japim disa konsiderata të përgjithshme mbi padinë dhe veçanërisht mbi ushtrimin e padive që kanë lidhje me pavlefshmërinë e veprimeve juridike.

17. Padia si e drejtë procedurale ose, sikurse njihet ndryshe, padia në kuptimin procedural, ndryshon nga padia si e drejtë substanciale apo, sikurse njihet, padia në kuptimin material. Padia në kuptimin material është e drejta për të kërkuar me anë të gjykatës realizimin e një kërkitimi, që buron nga një e drejtë subjektive. Është e drejta që ka një person për të kërkuar realizimin me anë të forcës, të një të drejte subjektive, kundrejt një personi tjetër, pavarësisht nga vullneti i këtij të fundit. Në thelb, e drejta e padisë në kuptimin material është një e drejtë që i jepet mbajtësit të së drejtës subjektive që, në rast cenimi ose mohimi të kësaj të drejte, ta rivendosë atë duke iu drejtuar gjykatës.

17.1. Padia në kuptimin procedural është mjeti juridik, me anën e të cilit personat e interesuar, si dhe ata të autorizuar me ligj, i drejtohen gjykatës për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridiko-civile dhe për mbrojtjen e të drejtave civile.

18. Paditësi, nëpërmjet padisë, që plotëson kushtet formale të nenit 154 të Kodit të Procedurës Civile, synon dhënien e një vendimi gjyqësor konkret që ai e quan të mundur juridikisht për t’u zbatuar dhe të aftë për të larguar ose hequr situatën antiligjore të pretenduar prej tij.

18.1. Referuar nenit 42 të Kushtetutës në lidhje me termin “*kushdo*” të përdorur në këtë dispozitë, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se në të përfshihen ato subjekte që jo vetëm mund të ngrënë një padi, por që janë edhe titullarë të së drejtës materiale duke iu referuar një situatë të caktuar dhe konkrete dhe që synojnë të arrijnë një gjykim mbi vetë themelin e pretendimit të tyre, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo.

19. Padia ka për garanci kushtetuese të drejtën e përgjithshme për t’iu drejtuar gjykatës, por

¹ Kodi i Familjes, pjesa e dytë, kreu i dytë “Pavlefshmëria e martesës”, nenet 33-29.

vetë padia nuk është aspak e përgjithshme. Përkundrazi, padia duhet t'i referohet një situatë konkrete për të provuar cenimin ose shkeljen e një të drejte ose interesi të ligjshëm dhe individualizohet nga tre elemente konkrete: i) subjektet ose palët; ii) objekti (vendimi konkret që i kërkohet gjykatës për të mbrojtur të drejtën e cenuar ose të shkelur); dhe iii) shkaku (e drejta ose marrëdhënia juridike e cenuar që ndodhet në themel të kërkesës).

20. Duke iu kthyer çështjes së pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike dhe mjeteve juridike të kundërshtimit të tyre në gjykatë, Kolegjet e Bashkuara evidentojnë që përcaktimi në ligj se “*Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike*” (neni 92 i K.Civil) do të thotë se bëhet fjalë për pasojat juridike të dëshiruara dhe synuara nga palët. Por, jo rrallë herë, veprimi juridik mund të ekzekutohet dhe të prodhojë efekte, dhe pikërisht këto efekte rregullohen nga gjykata.

20.1. Në të kundërt, sikurse është rasti konkret, vetëm kërkimi i konstatimit të pavlefshmërisë së një veprimi juridik, i cili në kuptim të ligjit nuk ka prodhuar asnjë pasojë juridike, pa treguar shkaku e këtij kërkimi dhe pasojat që ai mund të ketë sjellë, nuk mund të merret në shqyrtim nga gjykata.

21. Gjykata, si për çdo gjykim tjetër civil, edhe në rastin e gjykimit të pavlefshmërisë së veprimeve juridike, nuk mund të dalë jashtë kornizës ligjore të parashikuar nga nenet 6 dhe 28 të Kodit të Procedurës Civile.

21.1. Në këto dispozita është parashikuar se “*gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet*” (neni 6) dhe se “*gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj...*” (neni 28).

21.2. Nëse gjykata zgjidh pasojat juridike të një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm, pa kërkesë të palës ose tej asaj që pala ka kërkuar, nuk bën gjë tjetër veçse zëvendëson padinë e paraqitur me një padi të ndryshme, duke shkelur parimin procedural të përputhjes ndërmjet kërkesës së bërë nga palët dhe asaj që gjykata duhet të vendosë (nenet 6 dhe 28 të K.Pr.Civile).

21.3. Do të kemi të bëjmë me një vendim gjyqësor të marrë *ultrapetitionis* apo *extrapetitionis*, atëherë kur gjykata, duke ndërhyrë në pushtetin e palëve, ndryshon ndonjërin prej elementeve që individualizon padinë, duke i atribuar palës një marrëdhënie të ndryshme nga ajo e kërkuar, ose duke zëvendësuar padinë e paraqitur shprehimisht apo formalisht me një të ndryshme, të bazuar mbi fakte të ndryshme ose mbi një shkak ligjor të ndryshëm nga ai i kërkuar nga palët në themel të padisë.

22. Një ndër elementet që identifikon padinë dhe pa të cilin nuk mund të ketë padi është shkaku i saj (*causa petitionis*). Shkaku i padisë është arsyeja e kërkimit gjyqësor që përbëhet nga e drejta dhe nga një gjendje fakti që i kundërvihet kësaj të drejte. Që padia të merret në shqyrtim nga gjykata duhet të përmbajë në vetvete jo vetëm kërkimin që përbën objektin e saj, por dhe shkaku. Kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë pa treguar të drejtën dhe gjendjen e faktit që i është kundërvënë kësaj të drejte është një padi që në kuptim material nuk ekziston. Nuk ka padi pa shkak.

22.1. Është pikërisht shkaku i padisë, e drejta dhe gjendja e faktit që i kundërvihet kësaj të drejte, që përbën cenim të së drejtës së një subjekti/pale dhe që e motivon atë të vërë në lëvizje gjykatën (neni 32/a/b i K.Pr.Civile). Arsyeja e kërkimit, mbi të cilën bazohet padia, përbëhet nga e drejta materiale ku ajo themelohet, pra është e drejta materiale e afirmuar në bazë të së cilës përcaktohet objekti (*petitum*) dhe gjendja e faktit që i kundërvihet kësaj të drejte.

22.2. Edhe për këtë argument, gjykata nuk mund të ndryshojë kërkesëpadinë e paraqitur e që ka lidhje me një të drejtë të caktuar, me një të drejtë tjetër që në të parën nuk është përfshirë dhe nuk mundet, që vendimi i saj të ketë një përmbajtje të ndryshme nga ajo që kërkohet. Një vendim i tillë do të shkelë parimin procedural të përputhjes ndërmjet asaj që kërkohet dhe asaj që vendoset.

23. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se, derisa në një gjykim nuk kërkohet, të paktën zgjidhja e pasojave të pavlefshmërisë, gjykata nuk mund të shprehet në lidhje me pasojat e ardhura nga ekzekutimi i këtij veprimi juridik. Nëse gjykata kryesisht, *ex officio*, konstaton pavlefshmërinë e një veprimi juridik dhe zgjidh pasojat e pavlefshmërisë, duke i kthyer palët në të quajturën gjendje të mëparshme (*restitutio in integrum*) pa kërkesë të palës/palëve, ajo shkel parimin që paraprin procesin gjyqësor, sipas të cilit çdo padi është në varësi me të drejtën e kërkuar, për të cilën bën fjalë neni 31 i Kodit të Procedurës Civile.

24. Konstatimi i pavlefshmërisë së një veprimi juridik nga gjykata *ex officio* është i lejueshëm vetëm kur ajo ka në shqyrtim një padi themeli. Vetëm në rastin kur evidentohet zbatimi apo ekzekutimi i një veprimi juridik, në të cilin vlefshmëria është element konstitutiv i padisë, gjykata do të mund të konstatojë (në cilëndo gjendje apo shkallë të gjykimit) pavlefshmërinë e veprimit juridik, pavarësisht nga veprimet e ndërmarra e të ushtruara nga palët. Nëse veprimi juridik është i pavlefshëm, nuk ka në fakt efekte juridike për t'u eliminuar, sepse nuliteti është pikërisht mohim, nga ana e rendit juridik, i efekteve të veprimit juridik që është goditur.

25. Sikundër kemi parashtruar më sipër, ky rregull i përgjigjet përmbajtjes së nenit 92 të Kodit Civil të harmonizuar me kërkesat e neneve 6 e 28 të Kodit të Procedurës Civile, ose parimit të përputhjes të kërkesave të bëra nga palët me vendimin e dhënë nga gjykata.

26. Zgjedhja e llojit të padisë është në disponibilitetin e paditësit.

27. Referuar përmbajtjes së neneve 2 dhe 32 të Kodit të Procedurës Civile, personat fizikë dhe/ose juridikë, në ngritjen e padisë, ndër kushtet e tjera të parashikuara në po këtë Kod, duhet të gëzojnë legjitimitet aktiv dhe pasiv. E thënë ndryshe, ato për të parashtruar kërkimet, prapësimet dhe pretendimet e tyre para gjykatës, është e domosdoshme që të jenë titullarë të një interesi të ligjshëm dhe kërkimin ta kundër drejtojnë ndaj personit/personave mbi të cilët rëndon detyrimi juridik përkatës.

28. Interesi për të ngritur një padi është një element i së drejtës së padisë. Ai dallon nga interesi material për mbrojtjen e të cilit shërben padia. Kjo për arsye sepse janë të dallueshme dy të drejta, ajo materiale dhe ajo procedurale, që ushtrohet për mbrojtjen e së parës. Interesi për të ngritur padi është një interes procedural, dytësor dhe instrumental në lidhje me interesin material dhe ka për objekt masën ose llojin e vendimit që i kërkohet gjykatës si mjet për arritjen e përmbushjes së interesit material i cili është cenuar apo shkelur nga sjellja e palës tjetër ose nga gjendja faktike objektive ekzistuese. Pra, interesi për të ngritur padi lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material dhe për këtë arsye, në esencë, presupozon njohjen e cenimit të një interesi që mund të përmbushet duke kërkuar mbrojtjen në gjykatë. Në këtë vështrim juridik nuk mund të merret në shqyrtim një padi kur në situatën faktike, aktuale, nuk njihet apo nuk evidentohet cenimi i një të drejte ose i një interesi që mund të pretendohet kundrejt palës tjetër.

28.1. Interesi për të ngritur padi rezulton nga marrëdhënia midis situatës së kundërligjshme që pretendohet dhe vendimit gjyqësor që kërkohet të merret për të rregulluar këtë situatë nëpërmjet zbatimit të së drejtës në fuqi, marrëdhënie që domosdoshmërisht duhet të konsistojë në dobishmërinë e vendimit që kërkohet të merret.

29. Mungesa e një interesi do të thotë se, nëse ushtrimi i padisë nuk i siguron paditësit asnjë avantazh, gjykata duhet ta deklarojë atë si të papranueshme.

30. Dhe po kështu, nëse mungon apo paditësi nuk arrin të provojë faktin cenes të së drejtës së tij, Padia është e papranueshme.

30.1. Paditësi është i detyruar të provojë ekzistencën e disa kushteve ligjore para gjykatës, kushte të cilat lidhen me vetë ekzistencën e interesit të tij të ligjshëm për të ngritur padi. Mbrojtja apo rivendosja e interesit të ligjshëm të pretenduar si të shkelur, kërkon ndjekjen e një sërë hapash proceduralë për ta rivendosur. Çdo subjekt që pretendon se i është cenuar një e drejtë ose një interes i ligjshëm, nëpërmjet padisë, objektit dhe shkakut të saj, si dhe gjatë procesit gjyqësor civil, duhet të identifikojë: i) marrëdhënien juridike nga i burojnë të drejtat apo interesat e ligjshme të shkelura (p.sh.: marrëdhënie pronësie, kontraktore, trashëgime etj.); ii) personin që e ka cenuar në të drejtën apo interesin legjitim; iii) faktin që përbën cenimin e së drejtës ose interesit të ligjshëm, veprimet ose mosveprimet e të paditurit të cilat i kanë mohuar/cenuar të drejtën ose interesin e ligjshëm; iv) të drejtën që synon të realizojë, e cila duhet të jetë konkrete dhe të ketë lindur para ngritjes së kërkesëpadisë.

30.2. Në paditë që kanë për qëllim rivendosjen e një të drejte ose një interesi të ligjshëm të shkelur (neni 32/a i K.Pr.Civile), interesi për të ngritur padi është i dukshëm. Evidentimi i interesit për

të ngritur padi ka nxjerrë në pah qëndrime të ndryshme në lidhje me paditë që kanë për qëllim vërtetimin e qenies ose të mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte (neni 32/b i K.Pr.Civile) apo për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin (neni 32/c i K.Pr.Civile). Në këto dy rastet e fundit interesi për të ngritur padi buron nga paqartësia mbi ekzistencën e marrëdhënies juridike ose të së drejtës, apo nga pasoja juridike që sjell vërtetësia apo pavërtetësia e një dokumenti.

31. Në lidhje me germat “b” dhe “c” të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se interes të ligjshëm nuk ka vetëm në rastin kur kërkohet rivendosja e një të drejte të cenuar (germa “a”). Në germat “b” dhe “c” të këtij neni është parashikuar se mund të ngrihet padi dhe *“për vërtetimin e qenies ose mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte”*, si dhe *“për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin”*. Rasti i parashikuar në germën “c” nuk ka të bëjë me padinë objekt shqyrtimi. Ndërsa për rastin e parashikuar në germën “b” ka konfuzion në praktikën gjyqësore deri në parashtrimin se padia e konstatimit të pavlefshmërisë të një veprimi juridik bazohet në këtë germë.

31.1. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se e drejta për të ngritur padi, bazuar në germën “b” iu përgjigjet pretendimeve të palës që pretendon se ka një të drejtë subjektive materiale përkundrejt një personi tjetër, e drejtë kjo që gjen zgjidhje nëpërmjet një padie themeli me palë kundërshtare. Në dallim nga gërma “c”, e cila parashikon ngritjen e një padie me palë kundërshtare (jo për vërtetimin e një fakti juridik parashikuar nga neni 388 i Kodit të Procedurës Civile - gjykim gracioz) *“për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin”*, padia që bazohet në germën “b” është e ndryshme për nga rezultati që kërkohet të arrihet nga një proces gjyqësor civil.

31.2. Nëpërmjet padisë për vërtetimin e qenies ose mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte, synohet të realizohet marrja/nxjerrja e një vendimi gjyqësor, nëpërmjet të cilit i padituri të njohë të drejtën subjektive të paditësit (p.sh. pronësinë mbi një send, të drejtën e qenies së tij trashëgimtar–padia e kërimit të trashëgimit etj.), apo ekzistencën e një marrëdhënieje juridike (pronësie, kontraktore apo jashtëkontraktore etj.), e cila mbart për palët e gjykimit të drejta dhe detyrime civile. Në këtë këndvështrim juridik, padia e bazuar në këtë dispozitë është padi themeli dhe jo për të vërtetuar apo konstatuar pavlefshmërinë e një veprimi juridik, që nuk prodhon efekte juridike. Kjo padi nuk ka të bëjë me veprimin juridik si akt shpresor, për të cilin, nëse ka pretendime për vërtetësinë apo pavërtetësinë, gjen zbatim padia e bazuar në nenin 32/c të Kodit të Procedurës Civile.

31.3. Në thelb, me anë të padisë së parashikuar në germën “b” të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile synohet vërtetimi i qenies ose mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte ku veprimi juridik përdoret si mjet provues, si fakt krijues, shues apo ndryshues i marrëdhënies juridike që bëhet objekt i shqyrtimit gjyqësor.

32. Sjellim në vëmendje se padia e njohjes mund të paraqitet edhe veçmas për të bërë të mundur realizimin e mbrojtjes të një të drejte subjektive. Kështu, për mbrojtjen e pronësisë mund të shërbejë dhe padia e vërtetimit, njohjes ose deklarative. Pronari mund ta ngrejë këtë padi me qëllim që të vërtetojë gjyqësisht të drejtën e tij të pronësisë, se është pronar i sendit ose mos qenien e një të drejte që i kundërdrejtohet të drejtës së tij të pronësisë. Në këto raste shkaku i padisë është pronësia e cila duhet t’i njihet paditësit nga i padituri, por kur kërkohet thjesht konstatimi i pavlefshmërisë së veprimit juridik, pa u kërkuar njohja e një të drejte subjektive, ndodhemi përpara ekzistencës ose mosekzistencës të një fakti apo një rrethane dhe jo të një të drejte apo marrëdhënieje juridike.

33. Në lidhje me subjektet që mund të godasin veprimin juridik absolutisht të pavlefshëm, krahas asaj që është parashtruar në pikën 18.1 të këtij vendimi, Kolegjet e Bashkuara parashtrajnë se shprehja *“kushdo që ka një interes”* që përdoret për të përcaktuar subjektet e legjitimuara për të goditur pavlefshmërinë e një veprimi juridik/kontrate, iu referohet palëve të treta, që nuk kanë nënshkruar kontratën dhe/ose kanë mbetur të panjohur për ekzistencën e saj, dhe jo vetëm palëve që kanë nënshkruar, që si të tilla janë gjithmonë të legjitimuara, pasi është *hoc ipso* interesi i tyre për konstatimin e pavlefshmërisë. Legjitimiteti i përgjithshëm, sipas të cilit pavlefshmëria mund të kërkohet nga kushdo që ka një interes dhe mund të konstatohet kryesisht edhe nga gjykata, nuk

përfshihet palën nga tregimi i ekzistencës të një interesi të tijin konkret për të vepruar (neni 12 i Kodit të Procedurës Civile).

34. Pavlefshmëria absolute mund të parashtrohet nga çdo palë ndërgjyqëse që ka interes edhe nëpërmjet prapësimit.

34.1. Prapësimi, si mjet procedural i të paditurit ndaj një padie të ngritur kundër tij parashikohet në mënyrë implicite në nenin 31§2 të Kodit të Procedurës Civile. Nisur nga formulimi i kësaj dispozite rezulton se i padituri në një gjykim të filluar mund t'i kundërdrejtojë paditësit arsyet që nga pikëpamja e faktit apo e ligjit i bëjnë të papranueshme kërkimet e tij të paraqitura me anë të padisë. I padituri me anë të prapësimit nuk del me kërtime të veçanta dhe gjykimi i çështjes përqendrohet brenda kuadrit të kërtimeve të paditësit të shprehura në objektin e padisë. ^[2]

34.2. Nga tërësia e fakteve penguese, shuese apo ndryshuese, që qëndrojnë në thello të prapësimit, ka të tillë që gjykata i merr në konsideratë kur rezultojnë të vërtetuara edhe nëse i padituri nuk i bën objekt të prapësimit të tij. Si rast të kësaj natyre përmendim atë të plotësimit të afatit prekluziv (neni 140 i K.Civil) dhe, për sa arsyetohet më sipër, edhe rastin e konstatimit në mënyrë incidentale nga gjykata të pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik.

35. E ndryshme nga prapësimi është kundërpadia (neni 160 i K.Pr.Civile). Kundërpadia është një mjet dhe e drejtë subjektive procedurale që i njihet të paditurit për të mbrojtur të drejtat dhe pretendimet apo kërkimet e tij gjatë gjykimit. Në ndryshim nga prapësimi, kundërpadia jo vetëm që zgjeron objektin e hetimit gjyqësor, por edhe kufijtë e vendimit. Ajo del përtej kufijve të padisë dhe, referuar nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, është jo vetëm pjesë e pjesës përshkruese arsyetuese e të vendimit gjyqësor, por edhe pjesë e pjesës të dispozitivit të vendimit.

35.1. Në këtë analizë theksojmë se është i domosdoshëm një identitet pjesor i shkakut, sepse kundërpadia pranohet si e tillë të gjykohej së bashku me padinë, në qoftë se bazohet mbi marrëdhënien juridike materiale të bërë objekt gjykimi nga paditësi dhe të cilën i padituri e kundërshton nëpërmjet një fakti pengues, shues ose nëse nga marrëdhënia juridike materiale objekt gjykimi ka lindur si pasojë e një fakti krijues një marrëdhënie tjetër juridike materiale (si në rastin e kompensimit neni 514 i K.Civil).

36. Mbi këto argumente, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se zgjidhja e pasojave të një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm, mund të kërkohej me anë të padisë ose kundërpadisë. Kjo në varësi të pozitës procedurale të palës, si paditësi ose i paditur.

37. Rithekojmë përmbajtjen e nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile, ku është përcaktuar se gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

37.1. Gjykata nuk mund të veprojë në kundërshtim me rregullimet e bëra në nenet 6 dhe 28 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas këtyre dispozitave, gjykata është e detyruar “... të shprehet mbi gjithçka që kërkohej dhe vetëm për atë që kërkohej”. Kështu gjykata, qoftë dhe në mungesë të një kërkitimi të veçantë, gjatë shqyrtimit të një padie themeli kryesisht konstaton pavlefshmërinë e një veprimi juridik dhe zgjidh pasojat në lidhje me sa është kërkuar në objektin e padisë së themelit, por jo tej këtij objekti.

37.2. Është paditësi ai që me padinë e tij tregon dhe jep lëndën mbi të cilën gjykata ushtron të drejtat dhe detyrat e ngarkuara nga ligji në dhënien e drejtësisë, por procesi gjyqësor zhvillohet në respektim të parimit të kontradiktorialitetit. Në respektim të këtij parimi dhe të neneve 3, 12, 18, 20, 31 dhe 32 të Kodit të Procedurës Civile edhe pala tjetër e thirrur në gjykim ka të drejtat dhe detyrimet e saj në zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor. Sikurse paditësi, edhe i padituri ka të drejtën dhe detyrimin të parashtrijë faktet në mbrojtje të pretendimeve të tij. Nëse mohon faktin krijues që paditësi ka vënë në thello të kërkitimit të tij ose mohon rrjedhojat juridike që paditësi pretendon të nxjerrë, sjellja dhe qëndrimi i të paditurit nuk del përtej kufijve dhe kushteve të mosmarrëveshjes së vënë para gjykatës nga paditësi. Në këtë rast, i padituri realizon mbrojtjen e tij nëpërmjet prapësimeve,

² Vendimi njësoes nr. 901, datë 14.7.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

duke iu kundërvënë fakteve juridike krijuese të parashtruara nga paditësi fakte të reja krijuese, shuese, ndryshuese apo penguese. Ngritja e një prapësimi zgjeron lëndën e çështjes në shqyrtim, sepse përfshin në debatin gjyqësor edhe fakte të ndryshme nga ato të paraqitura nga paditësi, por nuk ndryshon kufijtë e vendimit të përcaktuar në objektin e padisë. Ky qëndrim buron nga përcaktimet e bëra në nenin 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe për rrjedhojë prapësimet janë pjesë e pjesës përshkruese arsyetuese të vendimit gjyqësor, dhe jo të pjesës urdhëruese të tij.

38. Sikurse u parashtrua më lart, gjykata gjatë shqyrtimit në themel të një padie, edhe kryesisht, konstaton pavlefshmërinë absolute të një veprimi juridik, por zgjidh pasojat vetëm brenda kërtimeve të padisë.

39. Në argumentim sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara, në funksion të njësimit të praktikës gjyqësore, arrijnë në këto përfundime:

39.1. *Veprimi juridik që është i pavlefshëm, mund të merret parasysh nga gjykata edhe kryesisht, pa u kërkuar nga pala e interesuar, madje edhe kundër vullnetit (dëshirës) të saj.*

Për të konsideruar një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm, nuk është e nevojshme paraqitja e një kërkesë të posaçme, qoftë kjo padi apo kundërpadi, pasi kjo lloj pavlefshmërie konstatohet pavarësisht nga paraqitja në gjykatë e kërkesës.

Pavlefshmëria absolute mund të parashtrohet nga çdo palë ndërgjyqëse që ka interes. Forma e parashtrimit mund të jetë edhe prapësimi, kjo për faktin se veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëparshëm.

39.2. *Kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik nuk mund të bëhet si kërkim i mëvetësuar; ai gjithnjë duhet të bëhet gjatë gjykimit në themel të një çështjeje nga gjykata, ose të paktën si kërkim që shoqëron zgjidhjen e pasojave të ardhura nga ekzekutimi i tij.*

39.3. *Pasojat e ardhura nga ekzekutimi (përmeshja) e një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm zgjidhen vetëm mbi kërkesën e palëve ndërgjyqëse dhe, në rastin kur gjykata kryesisht konstaton pavlefshmërinë e veprimit juridik, ajo zgjidh vetëm ato pasoja që janë objekt kërkimi të padisë apo të kundërpadiës, pa u shprehur për pasojat për të cilat nuk ka kërkesë konkrete nga palët. Kjo nuk pengon po këto palë apo persona të tretë të mund të kërkojnë në një tjetër gjykim zgjidhjen e pasojave të lëna në heshtje nga gjykimi ku veprimi juridik është konstatuar absolutisht i pavlefshëm.*

40. Duke pasur parasysh përfundimet e mësipërme të këtij vendimi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e vlerësojnë të gabuar qëndrimin e mbajtur nga të dyja gjykatat e faktit, të cilat kanë marrë në shqyrtim dhe kanë zgjidhur një çështje që ka për objekt vetëm konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik.

40.1. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se nuk mund të paraqitet si padi më vete konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik, sikurse ka vepruar pala paditëse, nëse ky kërkim nuk shoqëron gjykimin e një çështjeje në themel dhe/ose nuk shoqërohet me zgjidhjen e pasojave.

41. Për rastin konkret, ndryshe nga sa kanë arsyetuar gjykatat e faktit, nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmohet se jemi para rastit kur padia nuk mund të ngrihet dhe për rrjedhojë vendimet e gjykatave të faktit duhet të prishen dhe të pushohet gjykimi i çështjes.

42. Gjykatat e faktit, duke mos përcaktuar dhe mos identifikuar mungesën e shkakut të padisë, të konfliktit dhe mungesën e interesit për ngritjen e padisë, kanë gabuar në dhënien e vendimeve objekt rekursi.

43. Nga përmbajtja e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me anën formalo-juridike të formulimit të kërkesëpadisë, si dhe ato të ligjit material, ku pala paditëse e mbështet kërkimin, del qartë se padia në kuptimin material nuk plotëson kushtet ligjore për t'u marrë në shqyrtim. Padisë së palës paditëse, shoqërisë "Dinamika" sh.p.k., i mungon shkak i cili është i lidhur pazgjidhshmërisht me objektin, ç'ka passjell mungesën e interesit në ngritjen e kësaj padie.

44. Evidentohet se si në kërkesë padi, edhe gjatë gjykimit, nga ana e paditësit është kërkuar vetëm që veprimi juridik, kontrata e shitblerjes e lidhur mes të paditurve, të konstatohet absolutisht e pavlefshme.

44.1. Në shqyrtim të materialeve të dosjes gjyqësore, pretendimeve dhe prapësimeve të

palëve, vendimeve të gjykatave të faktit, si dhe rekursit, pra as në padi dhe as gjatë gjykimit, nuk evidentohet që paditësi t'i ketë paraqitur gjykatës ndonjë kërkim a pretendim mbi interesin konkret të ligjshëm, të natyrës reale apo të detyrimeve, që i është cenuar si pasojë e veprimit juridik për të cilin kërkon gjyqësisht konstatimin e pavlefshmërisë së tij.

45. Për sa më sipër, lidhur me zgjidhjen e çështjes konkrete, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se vendimi nr.47, datë 20.2.2007 i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe vendimi nr. 841, datë 6.10.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nuk gjejnë mbështetje në ligj dhe si të tilla duhet të prishen dhe, meqenëse ndodhemi përpara një padie që nuk mund të ngrihet, të vendoset pushimi i gjykimit të çështjes.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 141/2 të Kushtetutës, në nenin 485/e të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në nenet 17 pika "a" dhe 1984 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSËN:

Prishjen e vendimit nr. 47, datë 20.2.2007 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe të vendimit nr. 841, datë 6.10.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim është njësuës për praktikën gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Besnik Imeraj (kryesues), Ardian Dvorani, Gani Dizdari, Guxim Zenelaj, Ardian Nuni, Fatos Lulo, Majlinda Andrea, Arjana Fullani, Evelina Qirjako, Medi Bici, Mirela Fana, Aleksandër Muskaj, Shkëlzen Selimi, Artan Zeneli, Edmond Islamaj.

